

VENDIM
Nr. 16, datë 18.2.2019

**MBI SHTYRJEN E AFATIT TË ZBATIMIT TË KONTRATËS TIP PËR SHITBLERJEN
E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE/KESH SHA, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN
PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT
UNIVERSAL PËR PERIU DHËN 1.1.2018–31.12.2018 DHE KONTRATËS PËR
SHITBLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË ENERGJISË ELEKTRIKE QË REZULTON
PAS PËRMBUSHJES SË KËRKESËS SË KLIENTËVE QË PËRFITOJNË NGA
SHËRBIMI UNIVERSAL, ME QËLLIM MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E
SHPËRNDARJES PËR PERIU DHËN KOHORE 1.1.2018–31.12.2018”**

(ndryshuar me vendimin e ERE-s nr. 122, datë 29.7.2019)

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 104, pika 4, germa a, e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative” nenit 5 dhe nenit 14 të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.2.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike në lidhje me miratimin e shtyrjes së afatit të zbatimit të kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal, për periudhën 1.1.2018–31.12.2018 dhe kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”.

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin e tij nr. 98, datë 30.4.2018, ka vendosur:

1. Të miratojë kontratën për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018.

Bordi i ERE-s, me vendimin e tij nr. 132, datë 7.6.2018 ka vendosur:

1. Të miratojë kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal për periudhën 1.1.2018–31.12.2018,

Konstatojmë se:

- KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. nuk kanë dakortësuar ende për vitin 2019 “Kontratën për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal”.

- Me qëllim zgjidhjen e problematikave që pengojnë miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, organizoi një seancë dëgjimore në datë 29.1.2019. Në këtë seancë u diskutua mbi problemet që palët kanë konstatuar në

kontratën në fuqi, e që lidhen me përcaktimin e sasive të energjisë elektrike të livruara konform zbatimit të kësaj kontrate për vitin 2018.

- Mungesa e kontratave të dakortësuara e për rrjedhojë edhe e vendimit të ERE-s lidhur me këtë çështje, nuk i liron shoqëritë nga detyrimi për të furnizuar konsumatorët me energji elektrike, por as nuk i transformon këto shoqëri në shtojca të njëra-tjetrës. KESH sh.a. ka për detyrim të furnizojë OSHEE sh.a., me një sasi të caktuar energjie elektrike, kundrejt çmimit të përcaktuar nga organi kompetent shtetëror bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për Sektorin e Energjisë Elektrike.

- Nga shqyrtimi i korrespondencës KESH sh.a.–OSHEE sh.a., gjatë gjithë vitit 2018 lidhur me zbatimin e kontratave të sipërcituara është vërejtur se, KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. kanë këndvështrime të ndryshme ndaj parashikimeve kontraktore ndërmjet palëve dhe për pasojë ka pasur refuzime të disa faturave nga të dyja palët, si dhe kanë pranuar pa kundërshtime të tjera.

- Palët nuk i janë drejtuar ERE-s më herët me kërkesë për interpretimit të dispozitave të “kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 98, datë 30.4.2018.

- Kontrata për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 98, datë 30.4.2018, mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, ndryshuar me VKM-në nr. 729, datë 8.12.2017, draftohet e dakortësohet nga palët dhe përcillet për miratim në ERE.

- Kontrata për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019”, nuk është depozituar në ERE për miratim.

- ERE ka detyrimin të rregullojë marrëdhënien kontraktore mes palëve KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. në funksion të parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, ndryshuar me VKM nr. 729, datë 8.12.2017.

- Pas shqyrtimit të rrethanave në lidhje me kontratat e sipërcituara, ERE e gjykon të arsyeshme që të shtyjë afatin e zbatimit të këtyre kontratave deri në paraqitjen e draft kontratave për vitin 2019 nga KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., dhe miratimin e tyre nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizuar.

2. Shtyrjen e afatit të zbatimit të kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/ KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal për periudhën 1.1.2018–31.12.2018, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 132, datë 7.6.2018, deri në paraqitjen e draft kontratës për vitin 2019 nga KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. dhe miratimin e saj nga ERE.

3. Për periudhën deri në miratimin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike / KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe OSHEE sh.a. për vitin 2019, nëse sasia e energjisë së livruar dhe të marrë, ndryshon nga sasia e energjisë së programuar për livrim, faturimet do të axhustohen nga palët në këtë kontratë për të

reflektuar ndryshimet e devijimet midis programit dhe sasisë aktuale të livruar.

4. Në çdo rast sasia dhe çmimi i shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal, nga shoqëria e prodhimit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, është sipas nenit 5, pika 2 e VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar.

5. Ky vendim e shtrinë fuqinë juridike që nga data 1.1.2019 dhe shteron me marrjen e vendimit të Bordit të ERE-s për miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2019, si dhe kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/ KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal për periudhën për vitin 2019.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Adriatik Bego